



RAPORT VJETOR

2  **2** 



RAPORT VJETOR

Sigma InterAlbanian VIG është një Kompani Sigurimi Jo – jete e cila operon në tregun shqiptar që prej vitit 1999 dhe është pjesë e Vienna Insurance Group që prej vitit 2007.

KONTAKT



+355 4 2258254
+ 355 694073849
0800 01 01



kontakt@sivig.al
www.sivig.al



Komuna e Parisit, Pall. Lura
Tirana, Albania




Mbrojmë atë që ka **vlerë për ju!**

TË DHËNA MBI

Sigma Interalbaniian VIIG

Emri i Shoqërisë:	Sigma Interalbaniian Vienna Insurance Group
Aktiviteti:	Operon në biznesin e sigurimit të jo jetës në Republikën e Shqipërisë dhe nëpërmjet degës së saj në Kosovë edhe Republikën e Kosovës.
Data e Themelimit:	Shkurt 1999
Bordi Mbikqyrës:	Z. Peter Hoefinger Kryetar Z. Christoph Rath Zv. Kryetar Z. Jonard Prodani Anëtar Z. Michael Hack Anëtar Znj. Sonja Raus Anëtar
Drejtor i Përgjithshëm:	Klaidi Çitozi
Bordi Drejtues aktualisht:	Klaidi Çitozi Artan Pjetërnikaj Ervin Rali
Aksioner Kryesor:	Shoqëria mëmë është Vienna Insurance Group Ag Wiener Versicherung Gruppe, Vjenë, Austri, e cila zotëron 89.05% të aksioneve.
Numri i punonjësve:	200



Sigma është kompania e parë private e sigurimeve në Shqipëri.

Që prej krijimit të saj, ka kaluar në shumë sfida në një treg ende të paformuar mirë. Aktualisht, ajo është një Kompani e standardeve evropiane, e cila ofron produkte për të gjitha bizneset dhe individët, duke mbrojtur kështu gjithçka që ka vlerë për klientin, shëndetin, pronën, biznesin!

PËRMBAJTJA

Tregu i Sigurimeve 2020	07
Profili i Vienna Insurance Group	08
Historiku i Sigma Inter Albanian VIG	13
Organigrama e Kompanisë	15
Sigma Inter Albanian në kohët e COVID - 19	17
Profili i Sigma Inter Albanian VIG	19
2020 në shifra	20
Risigurimet - një instrument i domosdoshëm	25
Menaxhimi i Riskut	26
Raporti i Auditimit të Brendshëm	29
Objektivat 2021	33
Projekte Sociale	35
Raport i Auditit të Pavarur	38

2020

TREGU I SIGURIMEVE

Gjatë vitit 2020 tregu i sigurimeve ka pasur një ulje prej 5.73%, krahasuar me vitin 2019. Volumi i primeve të shkruara bruto është ulur me 1,009,578 mijë lekë duke arritur shifrën 16,608,010 mijë lekë.

- ✓ Numri i kontratave arriti në 956,447 duke shënuar një ulje me 29.16% krahasuar me vitin 2019.
- ✓ Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jo-Jetës kapi shifrën 15,433,412 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 5.53% krahasuar me vitin 2019.
- ✓ Numri i kontratave në sigurimin e Jo-Jetës kapi shifrën 866,748 duke shënuar një ulje në masën 29.95% krahasuar me vitin 2019.
- ✓ Vëllimi i primeve të shkruara bruto në veprimtarinë e Jetës kapi shifrën 1,165,282 mijë lekë duke shënuar një ulje në masën 4.15% krahasuar me vitin 2019.
- ✓ Numri i kontratave në sigurimin e Jetës arriti në 89,689 duke shënuar një ulje në masën 20.47% krahasuar me vitin 2019.
- ✓ Gjatë vitit 2020, janë paguar gjithsej 7,560,213 mijë lekë dëme ose 18.55% më shumë se gjatë vitit 2019.
- ✓ Numri i dëmeve të paguara gjatë vitit 2020 është ulur me 790 dhe arriti shifrën 48,181 nga të cilat 46,314 dëme janë paguar nga shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës dhe 1,867 nga shoqëritë e sigurimit të Jetës.



PROFILI I VIENNA INSURANCE GROUP



»» Ne fokusohemi që klientëve tanë në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore, t'u ofrojmë produkte të përshtatura posaçërisht për nevojat e tyre. Strategjia jonë drejtohet nga përfiturshmëria afatgjatë dhe rritja e qëndrueshme e fitimit, duke na bërë një partner të besueshëm në këto kohë që ndryshojnë kaq shpejt. ««

Mbi 25,000 punonjës punojnë për Vienna Insurance Group (VIG), në rreth 50 kompani në 25 vende të ndryshme. Ne zhvillojmë zgjidhje për sigurimet duke u përputhur me nevojat personale dhe lokale, e cila na bën lider në industrinë e sigurimeve në Austri dhe në Evropën Qendrore dhe Lindore.

EKSPERTIZË DHE STABILITET

Vienna Insurance Group është një grup ndërkombëtar sigurimesh, me selinë qendrore në kryeqytetin Austriak. Pas rënies së Perdes së Hekurt në vitin 1989, VIG filloi zgjerimin e tij, nga një biznes totalisht Austriak në një grup internacional. VIG është sinonim i stabilitetit dhe ekspertizës për të siguruar mbrojtje financiare ndaj rreziqeve të ndryshme. Origjina e grupit, daton në vitin 1824. Afërsisht dy shekuj experiencë, të kombinuara me një fokus në aftësinë tonë kryesore, atë për t'u siguruar ndaj rreziqeve, formojnë një bazë të sigurt dhe të fortë për mbi 22 milionë klientët që ka Grupi.

FOKUS NË EVROPËN QËNDRORE DHE LINDORE

Përveç se në Austri, VIG e konsideron si tregun e tij edhe Evropën Qëndrore dhe Lindore. Grupi gjeneron më shumë se gjysmën e të ardhurave nga primet në CEE. Veprimet e VIG janë të fokusuar gjithashtu në këtë rajon. Kjo reflekton kryesisht, parashikimin për rritje ekonomike në Evropën Qëndrore dhe lindore, i cili mendohet se do të jetë dy here më e madhe se në Evropën Perëndimore, si dhe niveli i sigurimeve për frymë, i cili është shumë më i ulët se mesatarja Evropiane.

PREZENCË NE TREGUN LOKAL

Për VIG, mbrojtja e klientëve financiarisht nga rreziku është një përgjegjësi. Grupi ndjek një strategji multi brand të bazuar në tregjet lokale si dhe në menaxhimin lokal. Së fundmi, suksesi i grupit dhe afërsia me klientin është baza e çdo brandi individual dhe know – how lokal.

FINANCA TË FORTA & VLERËSIMI I KREDITIT

VIG ka një vlerësim A+ me një parashikim të qëndrueshëm, nga agjensia e mirënjohur e vlerësimeve, Standard & Poor's, që do të thotë që mbetet kompania e vlerësuar më mirë në indeksin e Bursës së Vienës, ATX. Vienna Insurance Group është e listuar jo vetëm në Vienë por edhe në Pragë. Ęiener Städtische Versicherungsverein – një aksioner kryesor i qëndrueshëm me një fokus afatgjatë – ka rreth 70% të aksioneve të VIG. Aksionet e tjera tregtohen në bursë.

<p>ALBANIA</p> <p>SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>INTERSIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>DENMARK</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>LIECHTENSTEIN</p> <p>VIENNA-LIFE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>ROMANIA</p> <p>OMNIASIG VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Asirom VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>DE VIATA BCR ASIGURARI VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>AUSTRIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>onau VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>ESTONIA</p> <p>bta VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Seesam VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>LITHUANIA</p> <p>bta VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SERBIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>WIENER RE Beograd VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>BELARUS</p> <p>КУПАЛА VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>FRANCE</p> <p>VIG Re</p>	<p>MOLDOVA</p> <p>DONARIS VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SLOVAKIA</p> <p>Kooperativa VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>KOMUNÁLNA POISTOVŇA VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>BOSNIA-HERZEGOVINA</p> <p>WIENER OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>vienna osiguranje VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>GEORGIA</p> <p>GPI VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>IRAO VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>MONTENEGRO</p> <p>Život WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SLOVENIA</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>BULGARIA</p> <p>BULSTRAD VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life BULSTRAD VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>novains VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>PENSION ASSURANCE COMPANY DOVERIE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>GERMANY</p> <p>InterRisk VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>VIG Re</p>	<p>NORTH MACEDONIA</p> <p>WINNER VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life WINNER VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ОСИГУРУВАЊЕ МАКЕДОНИЈА VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>SWEDEN</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>CROATIA</p> <p>WIENER OSIGURANJE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>HUNGARY</p> <p>UNION VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>NORWAY</p> <p>VIG VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>TURKEY</p> <p>RAYSIGORTA VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>CZECH REPUBLIC</p> <p>Kooperativa VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>ČPP VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>VIG Re</p>	<p>ITALY</p> <p>WIENER STÄDTISCHE VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>POLAND</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>InterRisk VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Vienna Life VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>wiener VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>UKRAINE</p> <p>КНЯЖА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>Life КНЯЖА VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>УКРАЇНСЬКА СТРАХОВА ГРУПА VIENNA INSURANCE GROUP</p>
<p>LATVIA</p> <p>bta VIENNA INSURANCE GROUP</p> <p>COMPENSA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<p>KOSOVO</p> <p>SIGMA VIENNA INSURANCE GROUP</p>	<td> </td>	

© 2020 vienna insurance group

WE ARE NUMBER 1
IN AUSTRIA, CENTRAL AND EASTERN EUROPE.

VIG
VIENNA INSURANCE GROUP
Protecting what matters.

GRUPI I SIGURIMEVE QË KRYESON NË
EVROPËN QENDRORE DHE LINDORE

NR. 1

Austria
Vendet Balltike
Bullgaria
Republika Çeke
Gjeorgjia
Maqedonia e Veriut

TOP 5

Shqipëria
Bosnia dhe Hercegovina
Kroacia
Kosova
Moldavia
Polonia

NO1 Lider
i tregut
në Austri
dhe CEE

Rreth

50

kompani të grupit

Përfaqësi
në

30

VENDE

Mbi

25,000

punonjës

VIG ka listuar aksionet që në

1994

në bursën e Vienës dhe
më vonë dhe në bursën
e Pragës.

Iu shërbejmë më shumë se

22

MILION KLIENTËVE

Vlerësimi më i mirë
në ATX:

A+
me parashikim
të qëndrueshëm

nga Standard & Poor's

Bashkëpunim me

ERSTE GROUP

Banka më e madhe e retail në CEE

Historiku i Sigma Interalbaniian VIIG

Sigma Interalbaniian VIENNA INSURANCE GROUP u themelua në 1999 dhe regjistrua në Gjykatën e Tiranës me Vendimin Nr.20487 me datë 3 shkurt 1999. Aktiviteti i saj rregullohet nga nenet e Ligjit Nr. 9901 me datë 14 prill 2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe Ligji Nr. 52 datë 22 maj 2014 "Për aktivitetet e sigurimit dhe risigurimit dhe ndërmjetësimin në sigurime dhe risigurime", dhe aktet nënligjore të dala në funksion të tij. Aktiviteti i saj kryesor është ofrimi i sigurimit për mjetet motorike, pronën, shëndetin dhe sigurime të tjera jo-jetë.

Në 2004 gjithashtu filloi aktivitetin e saj në Kosovë nëpërmjet degës së saj. Shumë shpejt pas krijimit të saj, Sigma vendosi të zgjeronte aktivitetin edhe në rajon, duke hapur degët e saj përkatësisht në Maqedoni dhe Kosovë. Në këto tregje, falë përvojës dhe ekspertizës së stafit, arriti shumë shpejt të pozicionohet si kompani lider.



Shkurt
1999

Tetor
2002

Shtator
2004



U themelua kompania e parë private në Shqipëri, SIGMA - Siguri e Madhe



Sigma hyn në tregun maqedonas dhe liçensohet nga autoritetet vendase. Filloi aktivitetin e saj në 2003.



Sigma liçensohet që të operojë në Kosovë dhe menjëherë pozicionohet si kompani lider në treg.

Në shtator të vitit 2007, Vienna Insurance Group vendosi të hyjë në tregun shqiptar, duke blerë aksione të kompanisë Sigma. Kjo kompani jo vetëm solli një frymë evropiane në tregun shqiptarë, por ishte një emër që përcillte gjithashtu stabilitet dhe siguri për klientët. Gjate vitit 2014, Sigma dhe Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP sh.a. u bashkuan.

Më 30 shtator 2014, emri i Shoqërisë u ndryshua nga "Sigma VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a në "Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP" sh.a.

Në Majtë vitit 2016, Z. Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lider historik i kësaj kompanie për t'ia pasuar menaxhimin e kompanisë, Z. Klaidi Çitozi.



Shtator
2007



Grupi më i madh i sigurimeve në Austri dhe CEE, Vienna Insurance Group, investon në tregun shqiptar të sigurimeve, duke bërë pjesë të grupit të saj, kompaninë Sigma

Tetor
2014




U bë bashkimi i kompanive Sigma dhe Interalbanian dhe tani operojnë në treg me emrin Sigma Interalbanian VIENNA INSURANCE GROUP

Maj
2016



Z. Qemal Disha tërhiqet nga detyra si lider historik i kësaj kompanie për t'ia pasuar menaxhimin, Z. Klaidi Çitozi, pjesë e kësaj kompanie prej shumë vitesh.

ORGANIGRAMA



BORDI I DREJTORËVE

Kompania Sigma InterAlbanian, menaxhohet nga Bordi i Drejtorëve i cili ka në përbërje të tij, Drejtorin e Përgjithshëm dhe dy anëtarë.



Z. Klaidi Çitozi

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Z. Çitozi është pjesë e kompanisë prej 15 vitesh, tetë vjet nga të cilat si anëtar i bordit, dhe që prej vitit 2016 edhe si drejtues ekzekutiv i kësaj kompanie. Ai është aktuar i certifikuar dhe me përvojë të gjatë në fushën e marrjes në sigurim. Ai është një ekspert shumë i mirë në sigurime, ndaj dhe mbikqyr departamentet kryesore teknike në kompani siç janë ai i Menaxhimit të Riskut, Marrjes në Sigurim, Risigurimeve, Aktuaristikën dhe Marketingun.



Z. Ervin Rali

ANËTAR BORDI

Z. Rali ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, duke qënë dhe një ndër pionerët e kësaj industrie, veçanërisht në zhvillimet e teknologjisë që ka pasur tregu. Ai iu rikthye kompanisë Sigma InterAlbanian në vitin 2016 si Anëtar i Bordit të Drejtuesve të kompanisë, duke pasur në fokusin e tij veçanërisht shitjet dhe zhvillimet teknologjike, digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve.



Z. Artan Pjetërnikaj

ANËTAR BORDI

Z. Pjetërnikaj iu bashkua Sigma InterAlbanian si Anëtar i Bordit Menaxhues në fillim të vitit 2021. Përpara kësaj periudhe, ai ishte i angazhuar në funksione të larta si drejtues në Policinë e Shtetit dhe në sektorin privat bankar. Në kompani është i angazhuar kryesisht me çështjet ligjore, mbikqyrjen e trajtimit të dëmeve, administrimit, financat dhe burimet njerëzore.

Sigma InterAlbanian

në kohët e COVID - 19

Viti që sapo lamë pas, ishte një periudhë mjaft e vështirë, plot me pasiguri dhe sfida, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë botën. Efektet e COVID – 19 lanë pasoja jo vetëm në shëndetin e njerëzve, por edhe në ekonominë dhe në psikologjinë e tyre. Qasja ndaj jetës tashmë është krejt tjetër, dhe fokusi i të gjithëve u zhvendos tek shëndeti, familja dhe siguria.

Pandemia kishte efekte të ndjeshme në të ardhurat e familjeve dhe bizneseve të vogla si dhe në mundësinë e njerëzve për t'u punësuar. Megjithë mbështetjen që u dha nga qeveria për një kategori të punësuarish, duke iu përshtatur profilit të punës si dhe ekonomive të prekura më së shumti nga panedima, sërish pasojat ishin të shumta. Efektet negative të pandemisë, ishin të pashmangshme, sidomos në sektorët e rëndësishëm që janë prekur nga kjo goditje, si turizmi, tregtia ose transporti.

Pavarësisht se industria e sigurimeve nuk ishte në fokusin e qeverisë për t'u mbështetur gjatë kësaj periudhe, tregu ynë u ndikua për shkak të kufizimit të lëvizjeve si brenda vendit ashtu edhe jashtë, duke shkaktuar kështu një rënie të ndjeshme të primeve nga sigurimet motorike, por mbi të gjitha u shkaktua një rënie e të ardhurave të agjentëve të shitjes, paga e të cilëve bazohet në varësi të performancës mujore. Gjatë këtyre muajve, kompania jonë vendosi që të bëjë kompromise financiare dhe vazhdoi të paguajë pagat e punonjësve pavarësisht shitjeve të kryera, duke dhënë kështu një ndihmë për të gjitha familjat e punonjësve të kompanisë. Gjatë kësaj periudhe, ishte me shumë rëndësi mbrojtja sociale dhe e shëndetit të punonjësve tanë dhe familjeve të tyre. Për fat të mirë, kufizimet e aktivitetit ekonomik, zgjatën për një periudhë të shkurtër, për shkak dhe të kostove të konsiderueshme financiare që kishin.


Pas fillimit të pandemisë në Shqipëri, në kompani u krijua "Grupi i menaxhimit të krizave" (GMK) me pjesëmarrje të anëtarëve të Bordit Drejtues dhe përgjegjësit e Departamenteve kryesore. U ndoqën dhe u komunikuan rregullat dhe kufizimet e vendosura nga Qeveria dhe çdo ndryshim që ndodhi. Masat iu përshtaten ndryshimeve të situatës në nivel lokal.

U lehtësuan kushtet për ofrimin e shërbimit për shitje si dhe trajtimin pagesave të dëmshpërblimeve për klientët. U morën masa për të patur në dispozicion likuiditete të nevojshme për përbalimin e detyrimeve ndaj punonjësve, klientëve dhe furnitorëve. U krijua një plan veprimi në lidhje me reduktimin e staftit dhe/apo orareve në punë. Në situatën e krijuar, Shoqëria mori në fokus sigurinë dhe shëndetin e klientëve dhe të punonjësve të saj.

U zbatuan me përpikmëri masat për ndjekjen e kushteve të nevojshme të higjienës dhe dezinfektimit për çdo punonjës dhe zyrë. U krijuan kushtet e përshtatshme për të punuar në zbatim të ruajtjes së distancës sociale. Takimet e nevojshme u zëvendësuan me komunikime elektronike ose konferenca telefonike. Rastet e pakta të konstatuara të infektimit të punonjësve me Covid-19 janë trajtuar bazuar në rregulloret e MSH, gjithçka është tejkaluar me sukses.

Situata të tilla dhe kriza që kaluam, janë gjithnjë një test i mirë për të vërtetuar fuqinë dhe aftësinë e kompanive për t'u përshtatur shpejt. Kompania jonë, arriti që të organizojë punën, për t'iu përgjigjur nevojave të klientëve jo vetëm për policia sigurimi, por edhe për trajtimin e dëmeve, duke koordinuar punën në distancë. Aftësia për t'u përshtatur ndaj kësaj situate me kosto efektive, u bë e mundur nga sistemi që përdorte e gjithë kompania si dhe niveli i procesve të digjitalizuara, në të cilin kompania kishte kohë që ishte fokusuar.

Gjatë kësaj periudhe u përmirësua qasja online ndaj klientëve, duke ofruar mundësi për blerje të policave online si dhe raportim i dëmit të ndodhur nëpërmjet aplikacionit ose emailit. Gjithashtu, shërbimi ndaj klientit ishte në çdo kohë i gatshëm, për të dhënë udhëzimet e duhura jo vetëm për produktet e sigurimit që mund t'ju nevojiteshin, por edhe asistencë në rast të infektimit të tyre me virusin COVID – 19. Situata të tilla duhen kthyer në mundësi për zhvillim, dhe automatizimi dhe digjitalizimi i proceseve për shkak të pandemisë, bëri që ne të jemi më pranë klientëve që preferojnë qasjen në distancë.



PROFILI I

SIGMA INTERALBANIAN VIG

Viti 2020, ishte një vit i mbrapshtë për të gjithë, jo vetëm në termat financiarë, por mbi të gjitha në ndikimet sociale dhe shëndetësore që pati në vendin tonë. Të ardhurat nga primet pësuan një rënie prej rreth 7%, të përafërt me mesataren e tregut. Edhe këtë vit, kompania vijoi të renditej e treta në treg me mbi 13% të tregut. Kompania ka ruajtur një strukturë të qëndrueshme të primeve dhe 23% e të ardhurave vijnë nga sigurimet vullnetare.

Pavarësisht nga sa pritej për shkak të kufizimit të lëvizjes për shkak të pandemisë, dëmet shënuan një rritje prej 15%, dhe Sigma Interalbanian VIG ka paguar rreth 30% të totalit të dëmeve të tregut. Kompania renditet e dyta në sigurimet motorike, me mbi 15% të tregut.

Është vijuar me pagesën e dëmeve të pasurisë gjatë vitit 2020, kryesisht dëmet e shkaktuara nga tërmeti, dhe kjo shifër arriti vlerën 3 milionë Euro.

Sigurimi i Aksidenteve dhe Shëndetit, pësoi një rënie në të gjithë tregun, kryesisht për shkak të pezullimit të disa aktiviteteve për shkak të pandemisë (fasoneri, miniera, etj) dhe mungesës së sigurimit të Aksidenteve Personale. Gjithsesi, megjithëse mesatarja e rënies së tregut për këtë portofol ishte 11.2%, Sigma Interalbanian arriti të ketë një aktivitet më të qëndrueshëm, dhe të kishte një rënie prej më pak se 4%. Ndryshe nga Aksidentet Personale, Sigurimi i Shëndetit pësoi një rritje të ndjeshme si asnjëherë më parë në treg, me afërsisht 16% më shumë sigurime shëndeti se viti i kaluar, dhe kjo rritje për Sigma Interalbanian ishte pothuajse sa dyfishi i mesatares së tregut, me 30% më shumë prime.

3 MLN EURO

Gjatë vitit 2020 janë paguar 3 milion Euro dëme të pasurisë.

Kompania e Dytë

Renditet e dyta në sigurimet motorike, me mbi 15% të tregut.

30% më shumë

Kompania shënoi një rritje në primet nga Sigurimi i Shëndetit, në masën 30%.

2020

në shifra

Sigma InterAlbanian ka pasur një ecuri të qëndrueshme gjatë vitit 2020. Ju kemi shërbyer më shumë se 120.000 klientëve duke ju ofruar produktet tona, dhe kemi dëmshpërblyer mbi 6.000 klientë. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto gjatë këtij viti kanë arritur shifrën afërsisht 17 milionë Euro dhe zotëron rreth 14% të tregut. Rreth 24% e këtyre primeve vijnë nga sigurimet vullnetare.

120.000 klientë

PRIME

17 mln EURO

Dëme të paguara

8 mln EURO

Provigjionet Teknike

mbi 30,5 mln EURO

Treguesi i Likuiditetit

237.3

Treguesi i Mjaftueshmërisë

137.8

AKTIVET

mbi 47 mln EURO

KAPITALI

mbi 10 mln EURO


HIGHLIGHTS 2020

Sigma Interalkanian ka paguar 550.000 Euro për dëmet e trajtuara në Fondin e Kompensimit, ose mbi 18% të totalit të këtyre dëmeve. Kompania ka 15 milion Euro dëme pezull, dhe pjesa më e madhe e kësaj vlere përbëhet nga dy dëme, të cilat janë për t'u vlerësuar në Gjykatë, dhe sipas gjykimit të kompanisë nuk janë subjekt mbulimi i Kushteve të Përgjithshme të kontratave përkatëse.

Ne jemi pararojë në sigurime, duke ofruar këshillim dhe produkte sigurimi për çdo biznes dhe individ, duke iu përshtatur nevojave dhe buxhetit të tyre. Ekipi ynë teknik është i aftë të ofrojë sigurime që i përshtaten çdo kërkesë dhe rrethane në vendin tonë. Njohuritë dhe eksperiencia e stafit tonë, është një ndër pikat e forta të kompanisë. Duke qënë se tregjet financiare janë gjithnjë në ndryshim, ne tregohemi të kujdesshëm që stafi ynë të trajnohet vazhdimisht që t'i përshtatemi sa më mirë dhe në kohë këtyre ndryshimeve. Në ekipin tonë kemi punonjës me njohuri teknike të shkëlqyera, por edhe ata me ekspertizën dhe njohuritë mbi ligjet dhe rregulloren në fuqi. Ky është një kombinim i shkëlqyer që na bën zgjedhjen e parë të klientëve që kërkojnë mbrojtje dhe siguri maksimale gjatë aktivitetit të tyre.

Nëpërmjet aplikimit të parimeve të marrjes në sigurim, administrimit të rreziqeve me kontrata risigurimi të klasit parë, ne kemi mundësi të marrim përsipër me garanci të plotë çdo lloj rreziku. Në çdo kontratë sigurimi jemi të mbuluar përveç se me kapacitetet tona, edhe me mbështetjen e VIG Re, e cila është e vlerësuar nga Standarts and Poors me A+. Mbështetja e padiskutueshme e aksionerit tonë kryesor, Vienna Insurance Group, na vë njëherësh edhe përpara përgjegjësisë që të synojmë t'i përmbahemi standarteve më të larta në ofrimin e shërbimeve.

Stafi i kompanisë, i cili ka një eksperiencë shumë të gjatë në sigurime, ofron asistencë teknike dhe shërbim klienti të shkëlqyer. Njohuritë e marra në trajnimet dhe edukimin e vazhdueshëm të punonjësve si në Shqipëri ashtu edhe në grupin VIG, i aplikojmë në punën tonë të përditshme, si në dizejnimin e produkteve të sigurimit, ashtu edhe në mënyrën e përqasjes së klientit apo trajtimit të dëmeve.



Pjesë e Vienna Insurance Group

Ne jemi krenarë që jemi pjesë e grupit VIG, rrënjët e të cilit datojnë më shumë se 190 vite më parë në Austri. Aktualisht ky grup operon në 25 vende të Europës Lindore dhe Qendrore me më shumë se 50 kompani. Ka një prej vlerësimeve më të mira nga Standards and Poors, A+ dhe një perspektivë e qëndrueshme, ndër kompanië e përfshira në indeksin ATX të Vienna Stock Exchange.

Dega jonë në Kosovë, vazhdon të jetë një histori suksesi, që prej shumë vitesh tashmë, dhe është një nga kompanitë lidere në treg bazuar në volumin e primeve të realizuara për të gjitha linjat e bizneseve.

Misioni, vizioni dhe premtimi ynë



MISIONI

Ne jemi sinonim i stabilitetit dhe kompetencës përsa i përket mbrojtjes nga rreziku. Ne përdorim eksperiencën, njohuritë dhe diversitetin tonë për të qënë më pranë klientëve tanë. E konsiderojmë përgjegjësinë tonë që të mbrojmë ato që kanë vlerë për klientët tanë.



VIZIONI

Ne duam të jemi zgjedhja e parë për klientët tanë. Grupet e interesit na shohin si një partner të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Kjo bën të mundur që ne të forcojmë pozicionin tonë si grupi lider në sigurime në Austri, Europën Qendrore dhe Lindore.



PREMTIMI YNË

Ne bëjmë të mundur që klientët tanë të jetojnë një jetë më të sigurt dhe më të mirë sepse ne: Mbrojmë atë që ka vlerë për ju!

VLERAT TONA




Diversiteti



Marrdhënia me klientin



Përgjegjësia



Siguroni

shëndetin, banesën, automjetin!



Ju ndihmojmë të **mbani premtimet** tuaja!

RISIGURIMET

NJË INSTRUMENT I DOMOSDOSHËM

Risigurimet janë një nga hallkat më të rëndësishme të kompanive të sigurimit, e cila ndihmon në rritjen e aftësisë paguese të kompanisë në rastin e ndodhjes së dëmeve të mëdha, siç kanë qenë dhe ato të dy tërmete të ndodhura në fund të vitit 2019. Kompania jonë, ka arritur të ketë një plan risigurimi të mirëmenduar dhe në këtë mënyrë arriti të dëmshpërblejë klientët e dëmtuar në kohë rekord, duke ruajtur kështu edhe qëndrueshmërinë e kompanisë.

Zgjedhja e kompanive risiguroese, është gjithnjë shumë e rëndësishme, jo vetëm për shkak të garancisë që ju ofrohet klientëve por edhe për shkak të asistencës dhe njohurive teknike të ofruara gjatë trajtimit të dëmit, si nga pikëpamja teknike ashtu dhe ajo menaxhimit të kërkesave për dëm, të cilat në rastin e katastrofave kanë një fluks shumë të madh brenda një periudhe të shkurtër kohe.

Në këtë kontekst, Sigma Interlbanian VIG, duke pasur edhe suportin e kompanisë mëmë Vienna Insurance Group, ka investuar në përzgjedhjen e partnerëve të fuqishëm për transferimin e riskut, të cilët ofrojnë një mbulim të plotë në raste dëmsh, qofshin ato individuale apo katastrofike, por gjithashtu ofrojnë një kontribut mjaft me vlerë në trajnimin e stafit për përballimin e situatave të vështira.

Padyshim që pandemia ka goditur dhe tregun e sigurimeve ashtu si dhe të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë. Produktet e sigurimit të Jo Jetës në Shqipëri ofrojnë mbulim për risqe të caktuara dhe si të tilla, pandemia nuk ka qenë e ofruar në asnjërën prej tyre.

Aktualisht, Sigma Interlbanian VIG ka në marrveshjen e saj të risigurimit, kompani risigurimi të klasit të parë, të cilët kanë dhe vlerësimin më të lartë nga Standards and Poors.

VIG RE	A(+)
Munich Re	AA-
Swiss Re	AA-
Allianz	AA
Hannover Re	AA
DVECK	A+
CHUBB European Group	AA
ROYAL & SUN ALLIANCE	A
Lloyd s Underwriters	A+

Parimi i vlerësimit dhe menaxhimit të riskut

Procesi i vetevlerësimit të risqeve dhe aftësisë pagueze është një proces i brendshëm që shoqëria do të kryejë çdo vit për të vlerësuar pershtatshmerinë e menaxhimit të riskut dhe pozicionin e saj të tanishëm dhe të ardhshëm të aftësisë pagueze, në rastet normale të funksionimit dhe në rast të ngjarjeve të jashtëzakonshme (stress testing).

Struktura e Menaxhimit të Riskut të Shoqërisë

Departamenti i Menaxhimit të Riskut është struktura përgjegjëse e monitorimit të riskut. Gjithashtu, struktura përfshin edhe një Komitet të Menaxhimit të Riskut, i miratuar nga Bordi i Drejtoreve.

Vetevlerësimi i Risqeve dhe Aftësisë Pagueze

Procesi i vetevlerësimit të Risqeve dhe aftësisë pagueze të shoqërisë përbehet nga disa faza:

- i. Procesi i Kontrollit të Risqeve
 - a. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve
 - b. Vlerësimi kualitativ ose kuantitativ
 - c. Monitorimi, masat dhe kontrollet
 - d. Raportimi
- ii. Prova e Rezistencës
- iii. Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftësisë Pagueze
- iv. Plani i Vazhdimësisë së Aktivitetit dhe Testimi i Tij
- v. Profili i Përgjithshëm i Riskut

Procesi i Kontrollit të Risqeve

Procesi i kontrollit të risqeve fillon me inventarizimin e tyre. Duke u bazuar në template të Vienna Insurance Group ("Shoqëria meme"), kemi bërë inventarizimin e risqeve kryesore të shoqërisë. Për çdo risk të identifikuar është bërë vlerësimi frekuence/shkalle e rëndësie, mënyrën që ata përdorin për vlerësimin e riskut dhe masat/kontrollet e ndermarra për secilin risk, nëse ka të tilla të nevojshme.

Prova e Rezistencës

Prova e rezistencës është një teknikë e cila përdoret për të matur ndjeshmerinë ndaj ngjarjeve që kanë një probabilitet të vogël për të ndodhur, por që kanë një efekt të konsiderueshëm kur ato ndodhin. Dy metodat kryesore të këtij testimi janë analiza e ndjeshmerisë dhe analiza e skenareve.

Faktoret makroekonomike kanë një efekt të madh në këto lloje testimi. Risqet si ato të tregut, të kreditit apo operacionale janë drejtperdrejtë të lidhur me luhatjet në normat e interesave, cmimet e asetëve, dhe kursin e këmbimit.



1. Identifikimi dhe kategorizimi i risqeve

Qellimi i procesit te inventarizimit eshte identifikimi dhe kategorizimi i Risqeve.

Risqet kryesore te identifikuar nnderkombetare jane:

- Risku i Tregut
- Risku i Marrjes ne Sigurim se Jo-jetes
- Risku i Marrjes ne Sigurim se Produktit te Shen-detit
- Risku i Aktiveve te Patrupezuara
- Risku i Falimentimit te Pales Tjeter
- Risku i Likuiditetit
- Risku Operacional
- Risku i nderprerjeve te aktivitetit
- Risku i perqendrimit te njohurive
- Risku i burimeve njerezore te pamjaftueshme
- Risku i hardware dhe infrastruktures
- Risku i software dhe i sigurise
- Risku i modelimit dhe kualitetit te te dhenave
- Risku i zhvillimit te IT
- Risku i projekteve
- Risku i perputhshmerise ligjore te lidhura me sigurimet
- Risku i perputhshmerise ligjore te tjera
- Risku i proceseve dhe organizimit
- Risku i gabimeve njerezore
- Risku Strategjik
- Risku i Reputacionit

2. Vleresimi kualitativ ose kuantitativ

Ne kete proces behet vleresimi i risqeve materiale. Vleresimi behet ne baze te dy parimeve : frekuenca dhe shkalla e rëndesise.

3. Monitorimi, masat dhe kontrollet

Monitorimi i te gjithe risqeve eshte i detyrueshem dhe kryhet te pakten nje here ne vit.

Ne kete proces monitorimi merr rëndesi vleresimi i bere i riskut dhe ndarja sipas shkalles se rrezikut.

4. Raportimi

Raportimi tek Bordi i shoqerise permban nivelet e risqeve dhe masat qe duhen marre per ato risqe te klasifikuara shqetesuese.

PARIMI i MENAXHIMIT TË RISKUT

Administrimi i Kapitalit dhe Niveli i Aftesise Paguese

Bazuar ne ligjin nr. 52/2014 date 22.05.2014, "Per veprimtarine e sigurimit dhe risigurimit", shoqeria duhet te mbaje nje fond garancie minimum ne shumen 370 milion leke (ose jo me pak se 1/3 e marzhit te aftesise paguese minimale).



Plani i Vazhdimesise se Aktivitetit dhe Testimi i Tij

Plani i vazhdimesise se aktivitetet eshte formuluar dhe eshte perditesuar nga shoqeria per tju pershtatur ndryshimeve ne strukturen e shoqerise. Ne plan parashikohen hapat qe duhet te ndermerren ne rast te llojeve te ndryshme katastrofash, si dhe percaktohen personat pergjegjes per grupet e ndryshme te punes.

Profili i Pergjithshem i Riskut dhe Konkluzioni

Duke konsideruar te gjitha analizen e mesiperme dhe gjetjet e rezultuara, arrijme ne perfundimin qe shoqeria ka nje nivel menaxhueshem te riskut ne teresi.

AUDITIMI I BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE PËR VITIN 2020

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2020 në shoqërinë Sigma Inter-albanian VIG është kryer në përputhje me Planin Vjetor 2020 dhe Planin trevjeçar 2020 – 2023 të Auditimit të Brendshëm, të cilat janë përgatitur bazuar në analizën e risqeve dhe janë miratuar në Mbledhjen e Këshillit Mbikqyrës të shoqërisë në muajin Dhjetor 2019. Pavarësisht kufizimeve të vendosura si pasojë e pandemisë Covid-19, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar planin e auditimeve për vitin 2020 në masën mbi 90%.

Korniza rregullatore në të cilën bazohet puna e Auditimit të Brendshëm në shoqërinë e sigurimit Sigma Inter-albanian VIG përbëhet nga: Dokumenti Parimet kryesore të Auditimit të Brendshëm të Vienna Insurance Group, Rregullorja Nr. 153 e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare “Për veprimtarinë e Njësisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit”, Karta e Auditimit të Brendshëm dhe Manuali i Auditimit të Brendshëm.

Gjatë vitit 2020, Departamenti i Auditimit të Brendshëm është përqëndruar më së shumti në auditimin e aktiviteteve të trajtimit të dëmeve, të shitjes dhe të administrimit financiar, si dhe në ato të marrjes në sigurim, të menaxhimit të riskut, të risigurimeve, dhe të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë departamentet në zyrat qendrore dhe degët e shoqërisë dhe duke mbuluar kështu plotësisht të gjitha fushat e veprimtarisë së saj.

Auditimet e realizuara gjatë vitit 2020 në aktivitetet e trajtimit të dëmeve janë fokusuar në përputhshmërinë me kuadrin ligjor në fuqi, me rregulloret e AMF dhe me rregulloret e brendshme të miratuara nga shoqëria.

Kontrollet e njësisë së Auditimit të Brendshëm, gjatë vitit 2020, kanë synuar të mbulojnë të gjitha klasat e dëmeve të raportuara, si ato materiale, motorrike (Kasko dhe TPL); dëmet e pronës, ashtu edhe dëmet jo-materiale, shëndetësore nga TPL, si dhe dëmet e sigurimit privat të shëndetit. Kontrollet e kryera në Departamentin e Dëmeve, VIG Services, janë fokusuar në korrektësinë e eksperimentit dhe saktësinë e vleresimit të dëmeve; në funksionimin e kontrollit të proceseve brenda departamentit; në kohëzgjatjen e trajtimit të dëmeve dhe në kujdesin për klientin.

Gjate auditimeve janë kontrolluar si të dhënat në databazën elektronike, regjistrimet në programin e dëmeve MBA dhe dokumentat e skanuar elektronikisht, ashtu edhe dokumentacioni fizik i arkivuar i dosjeve të dëmeve të paguara.

Gjate auditimeve janë kontrolluar si të dhënat në databazën elektronike, regjistrimet në programin e dëmeve MBA dhe dokumentat e skanuar elektronikisht, ashtu edhe dokumentacioni fizik i arkivuar i dosjeve të dëmeve të paguara.



Kontrollet në trajtimin e dëmeve materiale nga produktet e detyrueshme kanë konsistuar në afatet e regjistrimit dhe trajtimit në përputhje me rregulloret e AMF, problematikave lidhur me funksionimin dhe përmirësimin e programit informatik të trajtimit të dëmeve; në referencat dhe manualët e çmimeve të përdorura për vlerësimin e saktë dhe të drejtë të dëmeve dhe kryerjes në kohë të pagesës së dëmshperblimit.

Aktivitetet e shitjes drejtohen nga Departamenti i Shitjes në Drejtorinë e Përgjithshme dhe përbëhet nga Zyra Qëndrore, nga Degët e Shitjeve dhe Ndërmjetesit e licensuar të shitjes të shoqërisë Sigma InterAlbanian VIG.

Kontrollet e Auditit të Brendshëm për vitin 2020 në aktivitetet e shitjes janë fokusuar në zbatimin rregullores së brendshme të shoqërisë, regjistrimin e saktë dhe pa vonesa të policave të sigurimit në programin e shitjes, arkëtimin e primeve veçanërisht për produktet vullnetare, menaxhimin e llogarive të paradhënies për shitjen, duke u bazuar edhe në kërkesat e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare për regjistrimin dhe raportimin në kohë reale të policave të sigurimit të detyrueshëm.

Gjithashtu puna audituese është përqendruar në zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të brendshme të Bordit Drejtues lidhur me menaxhimin e komisioneve dhe bonuseve të shitjes, procedurat e marrjes së agjentëve të rinj dhe largimin e agjentëve ekzistues, etj.

Kontrollet e shitjes së produkteve të detyrueshme, TPL, Karton Jeshil dhe Kufitare janë përqendruar më së shumti tek risqet e mundshme që shfaqen si pasojë e gabimeve në regjistrimet e policave të shitura në programin e shitjes, në saktësinë e të dhënave lidhur me kategorinë e automjetit, periudhën e sigurimit etj.

Përmbushja e funksioneve të administrimit, kontabilitetit dhe raportimit financiar është audituar gjatë vitit 2020 duke u fokusuar në: grumbullimin dhe dorëzimin në Byro të policave të detyrueshme TPL, KJ dhe KUFITARE (polica të furnizuara gjatë vitit 2020 dhe të pashitura deri në fund të vitit); rakordimet mujore të agjentëve të shitjes me degët dhe me Drejtorinë e Përgjithshme; në analizimin, ndjekjen dhe arkëtimin e primeve të paarkëtuara; në kontrollin dhe inventarizimin fizik të policave gjendje të furnizuara tek agjentët e shitjes; në zbatimin e procedurave për lëshimin e policave dublikatë dhe anulimin e policave; në funksionimin e programit MBA për administrimin e policave (rregjistrimi dhe raportimi në nivel police, i primeve, arkëtimeve, debitorëve, komisioneve dhe inventarit); si dhe në llogaritjen e komisioneve dhe bonuseve në përputhje me urdhrat e brendshëm të Bordit të Drejtorëve të Shoqërisë.

Administrimi kontabël i shoqërisë është audituar për saktësinë e rregjistrimeve në programin e kontabilitetit SAP tek VIG Services. Janë kontrolluar edhe raportimet brenda afateve në institucionet jashtë shoqërisë (AMF, DPT, Drejtoria e Pastrimit të Parave etj.), si dhe raportimet e brendshme për Departamentet e tjera, Bordin Drejtues dhe Këshillin Mbikqyrës.

Aktivitetet e marrjes në sigurim dhe menaxhimit të riskut gjatë vitit 2020 kanë funksionuar të harmonizuara me njëra tjetrën. Për çdo rast, Komiteti i Menaxhimit të Riskut ka analizuar risqet e mundshme dhe ka miratuar marrjen në sigurim dhe ofertat për përcaktimin e primit në përputhje me rregulloren e brendshme dhe urdhrat e Bordit të Drejtorëve të nxjerra për këtë qëllim. Shoqëria i ka kushtuar vëmendje dhe ka përmirësuar dokumentacionin e nevojshëm për analizimin e risqeve të marrjes në sigurim të pronave.

Funksionet e trajtimit të dëmeve, të kontabilitetit dhe të teknologjisë së informacionit janë transferuar në një kompani shërbimi, VIG Services Shqipëri. Kriteret e ofrimit të shërbimeve të transferuara dhe treguesit e performances janë të përcaktuara në Marrëveshjen e Nivelit të Shërbimit (SLA Agreement) ndërmjet shoqërisë Sigma Inter-Albanian VIG dhe VIG Services Shqipëri. Kjo marrëveshje është përditësuar në muajin Tetor 2017 dhe për pjesë të veçanta në mënyrë të vazhdueshme.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit gjatë vitit 2020 është audituar lidhur me shfrytëzimin e sistemeve dhe programeve informatike në përputhje me rregulloren e brendshme, implementimin e programit të ri të shitjes, administrimit dhe dëmeve (MBA), aplikimin e saktë të hierarkisë së të drejtave të përdoruesve, rinovimin e pajisjeve hardware dhe përditësimin e licencave në përdorim, dhënien e suportit IT për të gjithë përdoruesit e shërbimeve (punonjësit) si dhe mirëmbajtjen e sistemeve të sigurisë të instaluar në ambientet e shoqërisë.

Nga kontrollet në Departamentin e Ri-sigurimeve ka rezultuar se veprimtaria e risigurimit ka funksionuar e bazuar në Ligjin Nr. 52, datë 22.05.2014, "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", në Rregulloren e Grupit VIG për Risigurimet dhe në marrëveshjet e lidhura ndërmjet shoqërisë dhe risiguruesve përkatës. Partneri kryesor për aktivitetin e risigurimeve është VIG-RE i cili është pjesë e Vienna Insurance Group. Partnerët e tjerë janë përzgjedhur dhe miratuar bazuar në rankimet ndërkombëtare të institucioneve ndërkombëtare për shoqëritë e risigurimeve. Lista e risiguruesve është përditësuar periodikisht në përputhje me rregulloren e brendshme të Grupit VIG.

Kontrollet e auditit të brendshëm kanë konsistuar në përpushmërinë ligjore dhe të zbatimit të rregulloreve në fuqi, njoftimin në kohë dhe miratimin nga ana e Departamentit të Risigurimeve të Grupit VIG lidhur me risqet e mundshme dhe përcaktimin e ofertave. Gjithashtu janë audituar raportimet periodike në Autoritetin e Mbikqyrjes Financiare dhe në Grupin VIG lidhur me objektet dhe kontratat e risigurimeve.

Veprimtaria e Departamentit Ligjor është fokusuar në përfaqësimin dhe mbrojtjen e shoqërisë në proceset gjyqësore me objekt trajtimin e dëmeve, pasurore dhe jo-pasurore, si dhe ato të fondit të kompensimit. Gjithashtu pjesë e aktiviteteve juridike të shoqërisë janë ndjekja dhe mbështetja për grumbullimin e primeve të paarkëtuara nga klientët dhe subjektet debitore. Kontrollet e kryera nga Auditi i Brendshëm në aktivitetet juridike të shoqërisë gjatë vitit 2020 janë fokusuar në përcaktimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të vijnë nga zgjidhja me proces gjyqësor e mosmarrëveshjeve.

Opinion i shkurtuar i Auditit të Brendshëm për vitin 2020

Auditimet dhe kontrollet e brendshme të realizuara gjatë vitit 2020 kanë mbuluar të gjitha aktivitetet e shoqërisë në përputhje me planin vjetor. Angazhimet audituese janë finalizuar me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, të cilat janë pasqyruar në raportet e auditimit të dërguara në Bordin Drejtues të Shoqërisë Sigma Inter-Albanian VIG sha dhe në mënyrë të përmbledhur në Këshillin Mbikqyrës të saj.

Drejtuesi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Komitetin e Auditimit dhe Bordin Drejtues, duke marrë mbështetje të plotë për realizimin e rekomandimeve. Në mënyrë të vazhdueshme Departamenti i Auditit të Brendshëm ka monitoruar dhe dokumentuar realizimin e rekomandimeve të miratuara dhe statusin përfundimtar të tyre.

Bazuar në rezultatet e auditimeve të kryera gjatë vitit, Auditi i Brendshëm shpreh siguri të arsyeshme që aktivitetet e shoqërisë Sigma-Inter-Albanian VIG gjatë vitit 2020 janë kryer në përputhje të plotë me kuadrin ligjor për tregun e sigurimeve në Shqipëri. Theksojmë se në angazhimet tona audituese gjatë vitit 2020 nuk janë evidentuar gjetje kritike ose gabime materiale, të cilat të kenë një impakt domethënës në aktivitetin e shoqërisë.


OBJEKTIVAT 2021

Viti që sapo lamë pas, ishte një periudhë mjaft e vështirë, plot me pasiguri dhe sfida, jo vetëm për Shqipërinë, por për të gjithë botën. Efektet e COVID – 19 lanë pasoja jo vetëm në shëndetin e njerëzve, por edhe në ekonominë dhe në psikologjinë e tyre. Qasja ndaj jetës tashmë është krejt tjetër, dhe fokusi i të gjithëve u zhvendos tek shëndeti, familja dhe siguria.

Situata të tilla dhe kriza që kaluam, janë gjithnjë një test i mirë për të vërtetuar fuqinë dhe aftësinë e kompanive për t'u përshtatur shpejt. Kompania jonë, arriti që të organizojë punën, për t'iu përgjigjur nevojave të klientëve jo vetëm për polica sigurimi, por edhe për trajtimin e dëmeve, duke koordinuar punën në distancë.

Aftësia për t'u përshtatur ndaj kësaj situatë me kosto efektive, u bë e mundur nga sistemi që përdorte e gjithë kompania si dhe niveli i procesve të digjitalizuara, në të cilin kompania kishte kohë që ishte e fokusuar. Gjatë kësaj periudhe ne përmirësuar qasjen tonë online ndaj klientëve, duke ofruar mundësinë që të bëjnë blerjet e policave online por edhe të raportojnë dëmin e ndodhur nëpërmjet aplikacionit ose emailit. Gjithashtu, shërbimi ndaj klientit ishte në çdo kohë i gatshëm, për të dhënë udhëzimet e duhura jo vetëm për produktet e sigurimit që mund t'ju nevojiteshin, por edhe asistencë në rast të infektimit të tyre me virusin COVID – 19.





Duke marrë shkas nga situata e krijuar, një ndër objektivat kryesore ka qënë shëndeti dhe siguria e punonjësve, jo vetëm gjatë periudhës së COVID – 19, por edhe pas saj. Kjo situatë vuri në fokus të kompanisë që të rriten shitjet e sigurimeve vullnetare, veçanërisht sigurimi i shëndetit dhe pronës, si proces që zhvillon tregun e sigurimeve dhe sigurinë financiare shoqërore.

Gjithashtu, digjitalizimi i proceseve në shërbim të klientit, është një tjetër objektiv po aq i rëndësishëm. Procesi i digjitalizimit kishte filluar prej kohësh në kompani, por tashmë mori një tjetër vëmendje. Digjitalizimi dhe automatizimi i proceseve është një ndër prioritet e grupit VIG, kështu që edhe ne kemi synim të ecim me të njëjtin hap si kompanitë simotra në këtë drejtim. Së fundmi është punuar fort që të kemi një version të përmirësuar të aplikacionit SIVIG për celular si dhe shitjen online nëpërmjet web dhe aplikacionit.

Në këtë kontekst, është prioritet gjithashtu përmirësimi i shërbimit ndaj klientit, jo vetëm në trajtimin e dëmeve por edhe në prosecet e marrjes në sigurim. Gjatë vitit 2021 synohet të arrihet trajtimin i dëmeve motorike në një kohë më të shkurtër.

Kanalet tradicionale të shitjes janë një metodë shumë e suksesshme në Shqipëri, gjithsesi, duke u mbështetur në zhvillimet teknologjike, ne synojmë të shkojmë më pranë klientit nëpërmjet kanaleve alternative.

Qasja ndaj jetës tashmë është krejt tjetër, dhe fokusi i të gjithëve u zhvendos tek shëndeti, familja dhe siguria.

Mobilimi i bibliotekës në Qendrën e Solidaritetit.

Duke qënë pranë individëve dhe bizneseve prej kaq shumë vitesh, natyrshëm vjen dhe përgjegjësia e madhe jo vetëm ndaj klientëve të Sigma Interlbanian VIG, por dhe qytetarëve në nevojë. Kompania jonë ka qënë gjithnjë e ndjeshme ndaj këtyre rasteve, duke kontribuar për të lehtësuar sadopak gjendjen e tyre të vështirë.

Prej vitesh bashkëpunojmë me fondacionin “Fundjavë Ndryshe”, për të identifikuar rastet më në nevojë. I gjithë stafi i kompanisë ishte shumë entuziast kur u propozua që të ndihmoheshin një grup fëmijësh të fshatit Mamël, dhe të kontribuonim për transportin e tyre për në shkollë. Po aq entuziastë u treguan dhe aksionerët tanë në Vienë rreth këtij projekti, të cilin e vlerësuan me çmimin Gunther Geyer, në vlerën prej 20.000 Euro, të cilat duhet të përdoren përsëri në shërbim të komunitetit.

Ne e konsiderojmë arsimimin si themel i ndërtimit të një shoqërie të fortë dhe me vlera. Kjo ishte arsyeja për të cilën ne mbështetëm përsëri një projekt që ka të bëjë me forcimin e dijes. Ne shpresojmë që mobilimi i bibliotekës tek “Qendra e Solidaritetit”, i realizuar me këto fonde, të ndërtojë jo vetëm një koleksion të mirë librash, por një komunitet lexuesish të etur për dije.



Mbrojmë atë që ka vlerë gjatë pandemisë në Shqipëri.



Të moshuarit, gratë, fëmijët, adoleshentët, personat me aftësi të kufizuara, ata që jetojnë në zona të largëta nga qendrat e qyteteve, përjetojnë vështirësitë më të mëdha dhe preken akoma më shumë nga kriza gjatë situatave emergjente në Shqipëri. Kjo shkaktohet kryesisht nga mungesa e shërbimeve publike apo pamundësia e aksesit në to (për shembull për transportin publik), mbyllja totale si dhe mungesa e sistemit shëndetësor në këto zona.

Duke qënë shumë pranë këtyre shqetësimeve, Sigma InterAlbanian VIG vendosi që të mbështesë një pjesë të kësaj popullsie gjatë kësaj situatë emergjente. Ne ishim ende shumë entuziastë për çmimin Gunther Geyer që fituam nga kompeticioni ndërmjet kompanive VIG, kështu që vendosëm se kriza e cila po kalon populli ynë ishte një çështje e madhe e cila duhej mbështetur. Njerëzit në të gjithë vendin po luftojnë me varfërinë, duke qënë se shumica e bizneseve janë mbyllur. Disa janë prekur nga kjo situatë më shumë se të tjerët.

Në bashkëpunim me fondacionin Fundjavë Ndryshe, identifikuam familje të cilat jetojnë në zona të largëta dhe nuk kishin akses në dyqane apo markete pa përdorur transportin publik (i cili nuk funksiononte për shkak të pandemisë). Familjet që vendosëm të ndihmojmë jetonin në Kamëz dhe në Gramsh. Pakot që u dhuruan për çdo familje, përmbanin ushqimet bazike dhe detergjentë për një muaj. U siguroam që të gjitha familjet që morën pakot, të merrnin gjithashtu mesazhin nga kompania jonë se si të kujdeseshin për veten në këto kohë të vështira dhe masat që duhet të merrnin.

“Jetët tona janë ndikuar në mënyrë drastike dhe kufizimet janë të vështira për të gjithë. Ne po vëmë re që numri i njerëzve në nevojë po rritet dita ditës. T’i mbështesësh është një përgjegjësi njerëzore dhe qytetare. Si pjesë e politikave të përgjegjësive sociale të kompanisë tonë, ne mbështesim kauza të ndryshme, por besojmë se gjatë kësaj periudhe, duhet të fokusohemi totalisht në ndihmë të këtyre njerëzve. Falë kontributit të aksionerit kryesor të VIG dhe çmimit Gunther Geyer që fitoi kompania, na u krijua mundësia që t’i ndihmojmë gjatë pandemisë së COVID – 19” – tha z. Klaidi Çitozi, Drejtor i Përgjithshëm i Sigma InterAlbanian VIG.

Kjo iniciativë u vlerësua nga shumë persona, të cilët e shprehën mirënjohjen e tyre për kompaninë në rrjete sociale, në programe televizive, me emaille dhe telefonata.

COVID - 19

i thjeshtëzuar

Në fillimet e pandemisë, të gjithë ishin shumë konfuzë dhe po merrnin shumë informacion i cili jo gjithnjë ishte i thjeshtë për t'u kuptuar. Shkollat u mbyllën dhe kjo shkaktoi Akoma më shumë konfuzion, veçanërisht tek fëmijët. Sapo kishin kaluar një eksperiencë tjetër po aq të vështirë dhe lart mësuesve, shokëve dhe klasave të tyre, për shkak të mbylljes së shkollave nga tërmeti i Nëntorit 2019. Por kësaj here gjithçka ishte ndryshe, ata nuk po merrnin informacionin e duhur se çfarë ishte pandemia dhe si duhej të tregohej kujdes ndaj virusit.

Ekipi i marketingut të Sigma InterAlbanian VIG, vendosi të publikojë një video të thjeshtë të animuar, me informacionin e përshtatshëm për fëmijët në lidhje me Corona Virus dhe si duhet të sillen që të evitohen përhapjen e tij. Kjo video u publikua gjatë javës së parë të mbylljes së shkollave dhe u pëlqye shumë në rrjetet sociale. Shumë mësues ishin të interesuar të kishin videon, në mënyrë që ta shpërndanin tek nxënësit dhe kolegët e tyre, në mënyrë që të kishin një informacion më të plotë për situatën. Gjithashtu, urimi i fundvitit nga kompania, për punonjësit, kolegët, bashkëpunëtorët dhe klientët, ishte ai që të gjithëve na kishte munguar prej kohësh, "NJË PËRQAFIM"....

Uruam nga zemra që në 2021, të gjithë të mund të jepnin përqafime tek prindërit, gjyshërit, fëmijët, motrat dhe vëllezërit... një përqafim pa maska, pa distancë sociale, një përqafim TË VËRTETË!





RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Raporti i Audituesit të Pavarur

Drejtuar aksionerëve të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.

Opinionin ynë

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A. ("Shoqëria") më 31 dhjetor 2020, si dhe performancën e saj financiare dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Ne kemi audituar

Pasqyrat financiare të shoqërisë përfshijnë:

- pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2020;
- pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më atë datë;
- pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur më atë datë; dhe
- shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, të cilat përfshijnë politikat e rëndësishme kontabël dhe informacione të tjera shpjeguese.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen më tej në seksionin Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë.

Pavarësia

Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit (që përfshin edhe Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontabilistët ("kodi i BSNEK"). Ne kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin e BSNEK-së.

Informacione të tjera

Drejtimi është i përgjegjës për përgatitjen e informacioneve të tjera. Informacionet e tjera të cilat pritet të na vendosen në dispozicion pas datës së raportit tonë përfshijnë Raportin e ecurisë së veprimtarisë, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të auditimit.

Opinionin ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacionet e tjerat dhe ne nuk shprehim asnjë formë sigurie në lidhje me to.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më sipër kur të na vendosen në dispozicion dhe, gjatë këtij procesi, të vlerësojmë nëse informacionet e tjera nuk pajtohen në mënyrë të rëndësishme me pasqyrat financiare apo me kuptueshmërinë që ne kemi mbledhur gjatë auditimit, ose nëse informacionet e tjera përmbajnë anomali të rëndësishme.

Ky version i raportit tonë është përkthim i versionit origjinal të përgatitur në gjuhën Angleze. Janë marrë të gjitha masat që përkthimi të jetë një paraqitje sa më e mirë e versionit origjinal. Megjithatë, në lidhje me çështjet e interpretimit të informacionit, këndvështrimet apo opinionet, versioni i raportit tonë në gjuhën origjinale ka përparësi ndaj këtij përkthimi.

PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.
Rr. Ibrahim Rugova, Sky Tower 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2242 639, www.pwc.com/al



Kur ne të lexojmë Raportin e ecurisë së veprimtarisë, nëse ne arrijmë në përfundimin se në to gjenden anomali të rëndësishme, ne jemi të detyruar t'ia komunikojmë këto çështje personave të ngarkuar me qeverisjen.

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollet e brendshme, të cilat drejtimi i gjykon të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo pasaktësive.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të kryer veprimtarinë në vijimësi, duke vënë në dispozicion informacione për çështjet që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e aktivitetit, nëse është e zbatueshme, përveç rasteve kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë apo të ndërpresë aktivitetin, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të arrijmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare në tërësi, nuk përmbajnë anomali materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo të pasaktësive, dhe të lëshojmë një raport auditimi, duke përfshirë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk jep garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë, në rast se ekziston, një anomali materiale. Anomali mund të vijnë si rezultat i mashtrimit apo pasaktësive dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht apo të marra së bashku, ekziston një pritshmëri e arsyeshme që të kenë ndikim në vendimet ekonomike të marra nga përdoruesit në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë procesit të auditimit. Për më tepër, ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalisë materiale në pasqyrat financiare, si rezultat i mashtrimit apo pasaktësisë, hartojmë dhe kryejmë procedura auditimi që i përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe sigurojmë të dhëna të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në mënyrë që të shërbejnë si bazë për opinionin tonë. Rreziku për të mos identifikuar një anomali materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa një anomali si rezultat i pasaktësisë, për shkak se mashtrimi mund të përfshijë një marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosveprim të qëllimshëm, shtrëmbërim, ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë kuptueshmëri të kontrolleve të brendshme që mund të jenë të nevojshme për hartimin e procedurave të auditimit që u përshtaten rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrolleve të brendshme të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël, si edhe shënimeve shpjeguese të përgatitura nga drejtimi.
- Arrijmë në një përfundim në lidhje me përshtatshmërinë e parimit kontabël të vijimësisë së veprimtarisë të përdorur nga drejtimi dhe, bazuar në evidencën e siguruar të auditimit, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të ngjallin dyshime të rëndësishme në lidhje me aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Në rast se arrijmë në përfundimin që ekziston një pasiguri materiale, jemi të detyruar që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të audituesit në lidhje me shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare ose, në rast se shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencën e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të audituesit. Pavarësisht kësaj, ngjarje apo kushte në të ardhmen, mund të shkaktojnë ndërprerjen e vijimësisë së veprimtarisë së Shoqërisë.



- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë shënimet shpjeguese dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet në mënyrë të atillë që sigurohet paraqitja e drejtë.

Në komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, ndërmjet të tjerash, në lidhje me qëllimin dhe afatet e planifikuara të auditimit si dhe gjetjet e rëndësishme të konstatuara nga audituesi, përfshirë mangësitë e rëndësishme në sistemin e kontroleve të brendshme që identifikojmë gjatë auditimit tonë.

Armenia Services Shtetërore
PricewaterhouseCoopers Assurance Services SH.P.K.



Auditues Ligjor
Jonid Lamllari

1 qershor 2021
Tiranë, Shqipëri

Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group SH.A.

Pasqyra e pozicionit financiar

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lekë, përveçse kur përcaktohet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Aktive sftgjata materiale	11	311,654	327,316
Aktive afatgjata jo-materiale	12	57,434	64,268
Aktive të mbajtura për investime	13	68,500	72,850
Aktive me te drejte perdorimi	14	311,113	179,677
Aksione në shoqëri të lidhura	15	20,543	14,654
Aktive të risigurimit	16	2,671,737	2,437,422
Letra me vlerë me kosto të amortizuar	17	2,856,970	2,194,456
Tatimi mbi fitimin i arkëtueshëm		1,809	-
Depozita me afat me bankat	18	2,036,769	2,027,956
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	19	349,018	353,029
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	20	207,456	288,923
Aktive të tjera	21	131,114	133,768
Mjete monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara	22	305,494	312,762
TOTALI I AKTIVEVE		9,329,611	8,407,081
KAPITALI			
Kapitali aksionar	23	498,213	498,213
Rezerva e rezikut të sigurimit	24	171,792	171,792
Rezerva e rivlerësimit	24	60,706	64,683
Rezerva e përkthimit		(26,544)	(7,649)
Rezerva e bashkimit	24	333,207	333,207
Fitime të pashpërndara		812,779	616,452
TOTALI I KAPITALIT		1,850,153	1,676,698
DETYRIMET			
Detyrime për kontratat e sigurimit	25	3,945,765	3,459,519
Rezerva për primet e paguara	30	1,635,449	1,568,237
Detyrime tatimore të shtyra	39	6,503	7,205
Detyrime tatimore dhe të tjera të ngjashme	26	32,245	57,487
Detyrim për tatimin mbi fitimin		-	1,804
Depozita e risiguresit	27	1,244,524	1,187,940
Detyrime nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	28	296,402	245,479
Detyrim për qira afatgjate	14	318,570	182,712
TOTALI I DETYRIMEVE		7,479,458	6,730,383
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		9,329,611	8,407,081

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga bordi drejtues i njësisë raportuese më datë _____, dhe nënshkruar në emër të tyre nga:

Klaudi Çitozi
Drejtori Përgjithshëm



Ilir Elmazi
Drejtor Ekzekutiv i VIG Services

Shënimet shoqëruese në faqet 5 deri 48 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

	Shënime	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur 31 dhjetor 2019
Fitimi para tatimit		235,752	111,976
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit			
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimi	11,12	73,432	98,398
Ndryshime në vlerën e drejtë të aktiveve të mbajtura për investime	13	4,350	(647)
Zhvlerësimi për sigurimet e arkëtueshme	20	6,209	7,761
Të ardhura nga investimet	33	(156,798)	(147,735)
Fluksi i parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit para ndryshimeve në aktivet dhe detyrime		162,945	69,755
Ndryshime në të arkëtueshmet nga sigurimi e të tjera		75,258	(52,512)
Ndryshime në aktivet e tjera		2,654	26,856
Ndryshime në aktive të risigurimit		(234,315)	(493,749)
Ndryshime në kostot e shtyra të marrjes së sigurimit		4,011	256
Ndryshime në detyrime për kontratat e sigurimit		486,246	711,364
Ndryshime në rezervën për primet e paguara		47,212	76,284
Ndryshime në detyrime të tjera		56,584	-
Ndryshime në të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera		(25,242)	8,247
Ndryshime në detyrime të sigurimit dhe të tjera		50,923	(77,171)
Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet e shfrytëzimit përpara interesave dhe taksës		626,276	269,330
Tatim fitimi i paguar		(47,015)	(18,874)
Flukset monetare neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		579,261	250,456
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale e jo-materiale		(26,454)	(79,536)
Blerje e letrave me vlerë me kosto të amortizuara	11,12	(875,834)	(283,366)
Arkëtime nga letrat me vlerë të maturuara		238,023	40,000
Rënie në depozitat me afat	17	(5,116)	60,669
Interes i arkëtuar		126,914	138,263
Rritje në aksione në shoqëri të lidhura		(5,889)	-
Flukset monetare neto të përdorura nga aktivitetet investuese		(548,356)	(123,970)
Flukset monetare nga aktivitetet financuese			
Qira të paguara		(58,820)	(44,398)
Dividend i paguar		-	(85,000)
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese		(58,820)	(129,398)
Ulje neto në mjetet monetare dhe ekuivalente me to		(27,915)	(2,912)
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fillim të vitit		312,762	291,592
Efekti i kursit të këmbimit në mjetet monetare		20,647	24,082
Mjetet monetare dhe ekuivalentet me to dhe mjete monetare të kufizuara në fund të vitit	20	305,494	312,762



Mbrojmë atë që ka **vlerë për ju!**